



	REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA	
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - DREJTORIA KOSOVË POLJE		
DREJTORIA E ADMINISTRATIVËS - DIREKCIJA ZA ADMINISTRACIJË		
Nr./faq/Br. str.	33	
Datë/Datum	26.06.2020	
KOMUNA E FUSHË-KOSOVËS - DREJTORIA KOSOVË POLJE		

KOMUNA E FUSHË KOSOVËS

KONTRATA PUBLIKE KORNIZË

Komuna e Fushë Kosovës – Adresa: Rr. "Tahir Zemaj" nr.2 Fushë Kosovë (në vazhdim "Autoriteti Kontraktues"), në njëren anë;

dhe

Shpk "DRENI - A" Adresa: Rr. Llapi pn – Fushë Kosovë me numër unik identifikues 810749955 (ne vazhdim "Ofriuesi i Shërbimeve"), përfaqësuar nga Z. Bujar Morina – drejtor në anën tjeter, janë pajtuar te lidhin një kontratë publike për shërbimet në vijim:

Titulli: " Ofrimi i shërbimeve për bllokim dhe zhvendosje të automjeteve me marimangë"

Numri i Prokurimit: 612 20 2039 221

Numri i brendshëm: 612 20 039 221

Neni 1 Lënda

1.1 Lënda e kësaj kontrate publike kornizë është qe të themeloj kushtet, duke përfshirë çmimet për njësi dhe rregullat e implementimit për kryerjen e shërbimeve në vijim:

Ofrimi i shërbimeve për bllokim të automjeteve të parkuara gabimisht dhe zhvendosje të automjeteve me marimangë dhe transporti në vendin e caktuar. Shërbimi i transportit me "marimangë" tërheqjen bartjen e automjeteve që merren nga vendet ku është e ndaluar ndalja dhe parkimi i tyre, nga vendet ku ka ndodhur aksidenti në komunikacion, automjetet që mund të jenë të braktisura si dhe në raste të tjera, dhe vendosja e tyre në vendin e caktuar për këtë qëllim. Pas konstatimit të shkeljes së rregullave në komunikacion të evidentuar nga personat kompetent se automjeti është ndalur apo parkuar në mënyrë jo të rregullt, ai tërhiqet në bazë të urdhëresës së zyrtarit policor dhe kërkesës së personit të autorizuar nga organi i Komunës së Fushë Kosovës. Para se të jepet urdhëresa për zhvendosjen e automjetit, pozita e automjetit të ndalur ose parkuar në mënyrë jo të rregullt, dëshmohet me fotografi ose me skicë.

1.2 Kontrata publike kornizë do të implementohet me "vendosjen e porosive" apo thirrje. Ne baze te nevojave për tërheqje te automjeteve ne vende te parkuara jo ligjeshmerishte, dhe bazuar nga kërkesa e policisë se Kosovës për te pasur një kompani standarde ,bazuar ne udhëzimin administrativ nr. 02/2009/ PK te drejtorisë se përgjithshme te Policisë se Kosovës, 'ligjt nr.02/L-70 për siguri ne komunikacionin rrugor.

1.3 Ofertuesi i Shërbimeve NUK do të ketë të drejtë kompensimi dhe NUK do ti lejohet të bëjë ndryshime të çmimeve të njësisë.

1.4 Pagesa e-vetme e kryesit te shërbimeve do te jete tarifa e përcaktuar ne Ofertën financiare qe do ta paguaj pronari i automjetit dhe atë me fature — talon apo procesverbal te lëshuar , dhe pagesa do te behet në xhiroirologari te operatorit Ekonomik — kryesit te shërbimit qe do ta shënoj ne këtë urdhëpagesë.

1.5 Kontrata hynë në fuqi me 26.06.2020 dhe përfundon në datën 26.06.2023.

Neni 2 Koha e përfundimit

2.1 Afati kohor për kryerje të shërbimeve do të jetë 36 MUAJ.

2.2 Vendi i kryerjes se shërbimeve do të jetë : Territori i Komunës së Fushë Kosovës.

Neni 3 Çmimi

3.1 Çmimet njësi të shërbimeve janë paraqitur në Ofertën Financiare, Lista e Çmimit e paraqitur nga Ofruesi i Shërbimeve.

Shërbimet e zhvendosjes (me merimangë) dho blokimit të automjeteve në territorin e Komunës së Fuslie Kosove.

Nr. rendor	Pershkrimi	Njësia	Sasia	Çmimi €	Shuma €	Pikët					
1	Zhvendosja/Tërheqja e Motoçikletës, traktorit dhe veturës pa romorkio, brenda qytetit, deri në vendin përvendosje dhe ruajtjen e tyre deri në 24 orë	automjet	1.00	25.00	25.00	50					
2	Zhvendosja/Tërheqja e automjetit transportues, rimorkio, gjysëm rimorkio prej 3,5 ton e tutje si dhe autobusëve deri në vendosjen dhe ruajtjen e tyre deri në 24 orë	automjet	1.00	1.00	1.00	10					
3	Deponimi/nëse automjeti imbetet I depouuar në parking pas 24 orëve nga koha e marrjes, atëherë për të njejtin pronarë (drejtuesi) apo personi I autorizuar paguan për cdo 24 ore të deponiimit. Llogaria e 24 orëshit të radhës fillon menjëherë pasi kanë kaluar 24 orë që nga ora e tërheqjes së automjetit	automjet	1.00	3.00	3.00	20					
4	Zhvendosja/Tërheqja e mjetit (veturë, traktor, autobus kamion motocikletë etj) vetëm kur fillon por nuk bëhet zhvendosja deri në vendin e ruajtjes/Deponimit	automjet	1.00	10.00	10.00	10					
5	Zhblokimi I mjeteve, autobusëve, mjeteve transportuese, mjetet e punës dhe rimorkio	automjet	1.00	1.00	1.00	10					
				totali	40.00	100					
çmimi total		çmimi total i peshuar									
1	25.00				12.50						
2	1.00				0.10						
3	3.00				0.60						
4	10.00				1.00						
5	1.00				0.10						
40.00		14.30									
<p>Çmimi i Total i peshuar (ofertat do te viresohen ne baze te kesaq vlore). Kjo është vlera e cila do te duhet te shenohet ne Formularin e ofertes</p>											
<p>Kjo përgatitje është bërë, Në mbështetje të ligjit 02/L-70 dhe udhëzimit administrativ 02/2009.</p>											
<p>VËREJTJE : Të hyrat komunale duhet te jene 25 % per te gjitha pozicionet ne pershkrimin e çmimeve.</p>											

3.2 Çmimi i përmendorur në Nenin 3.1 më sipër duhet të jetë e vetmja paqesë Ofruosi i Shërbimeve per fiton nga Shkelsi i rregullave te Traflikut, ndersa tanten per cdo automjete te regjistruar —bartur do te paguaj Autoritetit kontraktues —Komunës sipas tarifës ne përqindje prej 25 % per cdo shërbim te kryer ,sipas kontratës publike kornizë.

3.3 Çmimet e njësive do të jene fikse dhe nuk do ti nënshtronen ndryshimeve per porositë e vendosura nën këtë kontratë publike kornizë.

3.4 Pagesa ndaj Komunes do te behet ne cdo muaj te perfunduar me raport me regjistrin e automjeteve te terhekura ,ne xhirologari te Komunes ne intervalin jo me shume se 15 dite .

3.5 Pas kesaj do te llogaritet kamata ditore prej 0.2% per cdo ditë të vonuar.

Neni 4 Obligimet e kryesit te sherbimeve .

4.1 Tërheqja - bartja e automjeteve bëhet me urdhër dhe nën kontrollin e Policisë, apo personit zyrtar qe do te përcaktoj terhekjen ,duke konstatuar gjendjen e automjetit para se të lëshohet urdhëresa për tërheqje.

4.2 Automjetet e ndalura ose të parkuara në mënyrë jo të rregullt zhvendosen, ndërsa autobusët, automjetet transportuese, makinat dhe automjetet e punes si dhe rimorkiot bllokohen dhe tërhiqen në bazë të urdhëresës së zyrtarit policor dhe kërkesës së personit të autorizuar nga organet e Administratës Komunale siç është inspektor i komunikacionit apo inspektor i komunal, në bashkëpunim me Policinë.

4.3 Në momentin e tërheqjes - marrjes së automjetit prej operatorit nga ana e pronarit, përvëç dëshmisi së pagesave, operatori duhet të kërkojë edhe dëshminë e pronësisë ose evidencën se personi që kërkon lëshimin e automjetit ka qenë duke drejtuar atë para se të bllokohej, përkatësisht para se të jetë tërhequr në vendin e caktuar për këtë.

4.4 Operatorit nuk i lejohet lëshimi i automjetit kur pronari ose drejtuesi i automjetit nuk jep dëshminë e kërkuar sipas paragrafit paraprak dhe bën pagesën e taksës sipas dispozitive të kësaj kontrate

4.5 Automjeti që nuk kërkohet të tërhiqet nga pronari (drejtuesi i automjetit) sipas nenit 2.1 të kësaj Rregullore, në afatin prej gjashët rruajshi nga dila e vendosjes në atë vend, automjeti do konsiderohet që eshte hjeke dore nga pronari dhe mjeti do të shitet në Ankand Publik dhe të hollat derdhen në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës .

4.6. Per shpenzimet e krijuara gjate tere kohes se mbetjes se automjetit ne lokacionin ne periudhen prej dites se dyte e deri ne gjashtemujor , Operatori Ekonomik do te percaktoj Tarifen e ruajtjes qe nuk do te jete me e madhe se 5 euro ne 24 ore ,mjetet të cilat do ti paguhen OE nga Buxheti i Konsoliduar i Kosovës.

4.7 Operatori i transportit me "marlmangë", eshte perzgjedhur përmes tenderit të shpallur përfomrimi e shërbimeve per bllokim dhe zhveridose lë aulorjeleve me "marlmangë", në bazë të kushteve më të volitshme të ofruara — Ankandit publik .

Neni 5 Obligimet dhe përgjegjësitet e operatorit.

5.1 Operatori është përgjegjës të plotësojë të gjitha dokumentet e nevojshme gjatë kryerjes së sigurimit fizik të autoparkut.

5.2 Afati për sigurimin e autoparkut zgjatë derisa zgjatë kontrata

5.3 Operatori është përgjegjës në rast keqpërdorimi, dëmtimi eventual gjatë ngarkimit -shkarkimit, bartjes deri në dorëzimin e automjetit në autopark (dëmin eventual të shkaktuar obligohet t'i kompensojë pronarit të automjetit).

5.4 Pas dorëzimit dhe vendosjes së automjetit në parking, përgjegjësia bie mbi personelin e sigurimit të autoparkut deri të bëhet tërheqja e automjetit nga pronari.

Neni 6 Kushtet për shërbimin e transportit me "marlmangé"

Operatori i cili ushtron këtë veprimtari, duhet t'i plotësojë këto kushte, ku ka deshmu qe i ka plotesuar kushtet me rastin e ofertimit

6.1 - I regjistruar si subject juridik.,

Ka katër automjete per bartjen e automjeteve,

Ka sistemin funksional të radio-lddhjeve,

Ka mkanizmin per bllokim ne vende të automjeteve te renda.

Ka lokacionin

Ka personelin

6.2 Lokacionin gjendet ne NTPSH "APOLONIA" Prishlinë me numer të Parcels sipas çertifikates kadastrale P — 71914059-01498-98 sipërfaqja 900 rn², e marrur me qera nga Pronari dhe kontaten e lidhur me datën 04.06.2020

Lokacioni ka siguri shërbimin 24-orësh, gjatë shtatë ditëve të javës,

Ka në dispozicion kontakt me telefon 24 orë,

Neni 7 Kushtet për automjetet bartëse gjate tere kohes se validitetit te kontrates .

7.1- Automjetet duhet gjate gjithe afatit te kontrates

Të janë të regjistruar,dhe teknikishtë ne rregull.

Të janë të dedikuara posaçërisht për bartjen e automjeteve, (tri automjete duhet të jetë me vinç, të ketë katër mengenet, të cilat duhet të vendosen në rrata të automjetit, kurse tjetri duhet të jetë me litar tërheqës (metalik), që ta bëjë ngarkimin e veturave.

Eshtë e preferuar të kenë ngjyrë të njëjtë,

T'i kenë pajisjet e parapara për ushtrimin e kësaj veprimtarie,

Të kenë drithë rrotulluese me ngjyrë të verdhë të vendosur mbi automjet dhe

Të kenë shenjat përkatëse të komunikacionit.

Neni 8. Kushtet për drejtuesit e automjeteve gjate tere kohes se validitetit te kontrates

8.1 Drejtuesit e automjeteve duhet:

Të janë në marrëdhënie pune te operatori,

Té kenë patnten e shoferit tê kategorisë përkatëse pér drejtimin e automjetit përkatës, Të kenë ndihmësin pér kryerjen e bartjes.

Té gjitha pagesat nga paragrafi paraprak do tê bëhen sipas kontratës, përmes bankës.

Taksat e shërbimeve do t'i vërtetojë Drejtoria pér Buxhet dhe Financa.

8.2 Pér secilën pagesë do tê lëshohet fatura, e cila do tè jeté me numër serik dhe do të përmbajë këto tê dhëna:

markën dhe modelin e automjetit,
numrin e targave,
emrin e plotë, adresën dhe numrin personal tê personit që i lirohet automjeti
datën e bllokimit tê automjetit,
datën e lirimt tê automjetit dhe vendin e lirimit (në vendqëndrimin e automjeteve apo në vendin ku është bllokuar).

Neni 9. Puna me bllokues

9.1 Sipas kësaj kontrate, operatori i perzgjedhur nga Komuna duhet tê jeté i pajisur me bllokues.
9.2 Sistemi i vendosjes së bllokuesve kryhet nga punëtorët e operatorit, né marrëveshje me policinë, né çdo kohë dhe né çdo vend.

9.3 Automjetit tê cilët i vendosen bllokuesit, pronari i tij obligohet tê paguajë gjobën sipas nenit 3, tê kësaj kontrate.

Neni 10 E drejta pér ankesë

10.1 Kundër urdhëresës pér zhvendosje ose bllokim lë automjeteve, pronari ose posuedesi i automjetit ka té drejtë ankesë në organin kompetent kunder Zyrtarit qe ka dhene urdheres per konfiskim, bartje apo terhekje e e automjetit

10.2 Nëse ankesa miralohet si e bazuar, ankuesit do t'l bëhet kompensimi i shumës së paguar per zhvendosjen ose bllokimin e automjetit, sipas dispozitive tê parapara në këtë kontrate

10.3 Ankesa nuk e shlyn pagesën e harxhimeve tê zhvendosjes, gjegjësisht tê bllokimit tê mjetit.

Neni 11 Lirimi nga tarifat e pagesave.

11.1 Nga pagesa lirohen:

Automjetet e zhvendosura ose automjetet që tërhiqen me rastin e konfiskimit nga ana e Policisë, me qëllim tê verifikimit tê dokumentacionit dhe tê automjetit, né rast se verifikimi rezulton i rregullt;

Automjetet e zhvendosura ose që tërhiqen, né rastet kur automjeti ka pësuar aksident dhe si pasojë ka ardhur deri te vdekja e personave në automjet dhe

11.2 Si dëshmi e plotësimit tê këtyre kritereve tê paragraft paraprak, Policia gjatë plotësimit tê raportit, duhet shënuar arsyen e tërheqjes - marrjes së automjetit.

'1 '1 .3 Nëse me vendim të Gjykatës verifikohet rregullsia e dokumentacionit dhe automjetit te konfiskuar nga ana e Policisë, tö cilin dokument pronari osc i autorizuar demeshperblimin do ta kerkoj nga Organi qe ka dhene urdher per konfiskim

Neni 4 Rendi i përparësisë së dokumenteve tê kontratës

4.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

- (a) Kontrata Publike Kornizë;
- (b) Kushtet e Veçanta tê Kontratës;
- (c) Kushtet e Përgjithshme tê Kontratës;
- (d) Oferta financiare (Lista e Çmimeve);
- (e) Urdhër blerja;

4.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste tê paqartësisë ose divergjencës, ato duhet tê lexohen sipas rendit tê përparësisë në tê cilin janë dhënë më sipër.

Neni 5 Komunikimet

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Ofriuesit të Shërbimeve nga ana tjeter duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të bëhen me shkrim. Komunikatat duhet të dërgohen me postë, mesazh, telefaks, faks, email ose të dorëzohen personalisht.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimit të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimit të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo qe në kontratë parashikohet dhënia e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftimin e tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njoftoj", "vërtetoj", "miratoj" ose "vendosë" "do të shenohen në përputhje me rrëthanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendimi i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsy.

5.4 Kjo kontratë është përgatitur në gjuhet Shqipe në katër origjinale, tri origjinale për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinal për Ofriuesin e Shërbimeve.

Për Autoritetin Kontraktues

Emri:	Bedri Obertinca
Pozita:	Zyrtar përgjegjës i prokurimit
Nënshkrimi:	
Data:	26. 06. 2020
Vula:	



Për Ofriuesin e Shërbimeve

Emri:	Donat Morina
Pozita:	Menzaxher
Nënshkrimi:	
Data:	26.06.2020
Vula:	



PJESA II E KONTRATËS

KUSHTET E PËRGJITHSHME

Neni 1 Përkufizimet

1.1 "Kontratë" do të thotë marrëveshja e lidhur ndërmjet Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve, siç është shënuar në formularin e kontratës të nënshkruar nga palët, duke përfshirë të gjitha shtojcat për këtë dhe të gjitha dokumentet e inkorporuar me referencë në të.

1.2 "Shërbimet" do të thotë shërbimet qe do te ekzekutohen nga ana e Ofruesit e Shërbimeve në pajtim me Specifikimet dhe Përshkrimin e Çmimit te përfshira në Tenderin e Ofruesit të Shërbimeve.

1.3 "Ofrues i shërbimeve" është Operatori Ekonomik ose grapi i Operatorëve Ekonomik, i caktuar në formularin e kontratës, që është palë në kontratë dhe i detyruar të kryej detyrat në bazë të marrëveshjes, dhë që përdetyrat e kryera do të marrë shumën e rënë dakord në formularin e kontratës.

1.4 "Personeli" do të thotë personat c angazhuar nga Ofruesi i Shërbimeve ose nga Nën-kontraktuesi si të punësuar dhe të caktuar për kryerjen e shërbimeve ose të ndonjë pjese të tyre.

1.5 "Çmimi i kontratës" do të thotë shuma e deklaruar në Marrëveshjen që përfaqëson shumën totale të pagueshme për ofrimin e Shërbimeve.

1.6 "Nënkontraktuesi" do të thotë çdo person fizik, privat ose subjekt i qeverisë, ose kombinimi i tyre, duke përfshirë edhe pasardhësit o tij ligjor oso transformimet o lojuara, për të cilin çdo pjesë e Shërbimeve do të sigurohet use ekzekutimi i ndonjë pjese të Shërbimeve është nënkontraktuar nga Ofruesi i Shërbimeve.

1.7 "Palë" nënkupton Autoritetin Kontraktues ose Ofruesin i Shërbimeve, siç mund të jolë rasti, dhë "Palë" nënkupton të dy prej tyre.

1.8 "Autoriteti Kontraktues" nënkupton autoritetin që blen Shërbimet, siç specifikohet në Kontratë.

1.9 "KPK" nënkupton Kushtet e Përgjithshme të Kontratës.

1.10 "KVK" nënkupton Kushtet e Veçanta të Kontratës.

Neni 2 Gjuha dhe ligji i aplikueshëm

2.1 KVK e saktësojnë cili është ligji që i përcakton të gjitha çështjet që nuk janë të mbuluara në kontratë.

2.2 Kontrata dhe të gjitha komunikimet o shkruara ndërmjot palëvo hartohen në gjuhën e specifikuar në KVK.

Neni 3 Transferimi

3.1 Transferimi do të jetë valid vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes të cilës Ofruesi i Shërbimeve e transferon kontratën e vet ose një pjesë të saj te një palë e tretë.

3.2 Ofruesi i Shërbimeve nuk mundet që, pa miratim paraprak me shkrim nga Autorileli kontraktues, ta transferojë kontratën ose një pjesë të saj, ose ndonjë përfitim apo interes nga ajo, përvèç në këto raste:

a) kur ka ngarkesë për pagesë, në favor të bankierëve të Ofruesit të Shërbimeve, të shumave që duhet të paguhen ose që do të bëhen borxh sipas kontratës; ose

b) në rast të dhënies së të drejtës së Ofruesit të Shërbimeve siguruesve të Ofruesit të Shërbimeve për të kërkuar pagesën nga ndonjë person tjetër i detyruar në rastet kur siguruesit e kanë shkarkuar humbjen ose detyrimin e Ofruesit të Shërbimeve.

3.3 Për qëllimet e nenit 3.2, aprovimi i një transferimi nga Autoriteti kontraktues nuk do ta lirojë Ofruesin e Shërbimeve nga obligimet e veta për pjesën e kontratës që tashmë është realizuar ose për pjesën që nuk është bartur.

3.4 Pranuesit e dispozitave të kontratës duhet të plotësojnë kriteret e përshtatshmërisë që zbatohen për dhëni e kontratës përvèç në raste kur transferimi bëhet në bankë apo kompani të sigurimit ose institucion tjetër financiar.

Neni 4 Nën-kontraktimi

4.1 Nënkontrata është valide vetëm nëse ka marrëveshje të shkruar përmes së cilës Ofruesi i Shërbimeve ia beson realizimin e një pjese të kontratës së tij një pale të tretë.

4.2 Elementet e kontratës që do të nënkontraktohen dhe identiteti i nënkontraktuesve i bëhen të ditura Autoritetit Kontraktues me rastin e dorëzimit te ofertes. Ne rast te ndryshimit te nënkontraktuesve gjate implementimit te kontrates, Ofrcuesi i Shërbimeve duhet te njoftoj me shkrim Autoritetin Kontraktues. Autoriteti kontraktues do ta lajmërojë Ofrcuesin e Shërbimeve për vendimin e vet brenda 30 ditë pune nga marrja e njoftimit, duke i paraqitur arsyet e veta nëse nuk lëshohet autorizimi. Ofrcuesi i Shërbimeve nuk nënkontraktion pa autorizim me shkrim nga Autoriteti Kontraktues. Te gjithe nënkontraktuesit e propozuar duhet te përbushin kërkesat e pershtatshmerise.

4.3 Autoriteti kontraktues nuk njeh lidhje kontraktore ndërmjet vetes dhe nënkontraktuesve, megjithatë mund të siguroj, ku e konsideronë si të nevojshme, pagesat direkte për nënkontraktorët.

4.4 Ofrcuesi i Shërbimeve është përgjegjës për aktet, gabimet dhe neglizhencën e nënkontraktuesve të vet si dhe të agjentëve ose të punësuarve, në të njëjtën mënyrë si po të ishin akte, gabime ose neglizhencë e Ofrcuesit të Shtëpia e Kombit, agjentëve lej lij ose punëlorëve lej lij. Aprovimi i nënkontraktimit të ndonjë pjese të kontratës ose aprovimi i nënkontraktuesit nga ana e Autoritetit Kontraktues nuk e liron Ofrcuesin e Shërbimeve nga obligimet e tij sipas kontratës.

Neni 5 Tatimi

5.1 Ofrcuesi i Shërbimeve është përgjegjës për të gjitha tatimet dhe detyrimet doganore në përputhje me Ligjin e Republikës se Kosovës.

5.2 Të gjitha tatimet dhe detyrimet tjera doganore konsiderohet se janë përfshirë në çmimin e kontraktuar.

5.3 Menaxheri i Projektit do të harmonizojë çmimin e kontraktuar nëse konstaton se ka ngritje të tatimeve dhe detyrimeve doganore brenda datës prej 28 ditësh para dorëzimit të tenderit dhe datës së fundit të vërtetimit të ekzekutimit te shërbimeve.

5.4 Menaxheri i Projektit nuk do të lejojë ndryshimin e çmimit të kontraktuar për shkak të ngritjes së tatimeve dhe/ose ngritjes se detyrimeve doganore në qoftë se kjo ka ndodhur gjatë kohës sa ka qonë në vonosë Ofrcuesi i Shërbimeve.

Neni 6 Fillimi dhe Ekzekutimi i shërbimeve

6.1 Ofrcuesi i shërbimit duhet të fillojë shërbimet sa më shpejt që është e arsyeshme e mundur pas marrjes së urdhrit me ekspeditën e duhur dhe pa vonesë.

6.2 Ofrcuesi i Shërbimeve do të përfundoj aktivitetet veprimtarit brenda afatit kohor të specifikuar në Nenin 2 të Formularit të Kontratës. Nëse Ofrcuesi i Shërbimeve nuk i përfundon aktivitetet në datën e caktuar, ai do të jetë përgjegjës për të paguar dëmet e likuiduara. Në këtë rast, Data e Përfundimit do të jetë data e përfundimit te të gjitha aktiviteteve.

Neni 7 Zgjatja e periudhës së ekzekutimit

7.1 Ofrcuesi i shërbimit mund të kërkojë zgjatje të periudhës së ekzekutimit nëse realizimi i kontratës së tij vonohet, ose pritet se do të vonohet, për ndonjërin nga këto arsyet:

- dështimi i Autoritetit Kontraktues për të përbushur detyrimet e tij sipas kontratës;
- forcë madhore siç përcaktohet në nenin 8;

7.2 Brenda 15 ditëve me të kuptuar se një vonesë mund të ndodhë, Ofrcuesi i Shërbimeve do të njoftoj Autoritetin Kontraktues mbi qëllimin o tij që të bëj një kërkësë për zgjatjen e periudhës së realizimit për të cilën ai konsideron se ka të drejtë dhe, përvëçse kur është rënë dakord ndryshe ndërmjet ofrcuesit të shërbimeve dhe Autoritetit Kontraktues, brenda 30 ditëve nga e njëjta pikë në kohë të sigurojë Autoritetin Kontraktues me hollësi të plotë në mënyrë që të mund të shqyrtohet kërkesa.

7.3 Brenda 30 ditëve nga marrja e hollësive lë përrimendura në 7.2, Autoriteti Kontraktues me anë të njoftimit me shkrinë do t'i lejoj Ofrcuesit të Shërbimeve zgjatjen e periudhës së ekzekutimit siç mund të arsyetohet, ose në mënyrë prospективë dhe retrospektive, ose të informoj Ofrcuesin e Shërbimeve që ai nuk ka të drejtë në zgjatje.

Neni 8 Forca Madhore

8.1. Asnjëra palë nuk konsiderohet se ka bërë shkelje të obligimeve të saj sipas kontratës nëse realizimi i obligimeve të tillë parandalohet nga ndonjë ngjarje e shkaktuar nga një forcë *madhore* që shkaktohet pas datës së njoftimit mbi dhënie të kontratës ose kur kontrata hyn në fuqi.

8.2. Termi "forcë madhore" do te thotë veprimet e zotit, goditjet, mbylljet e objektit ose çregullimet tjera industriale, veprimet e armikut publik, luftërat qofshin të deklaruara ose jo, blokadat, rebelimet, rastet e dhunës, epidemitë, rrëshqitjet e tokës, tërmetet, shtrëngatat, vetëtimë, vërsimet, erozionet, trazirat civile, eksplodimet dhe ndonjë ngjarje

tjetër e ngjashme e paparashikuar që është përtej kontrollit të palëve dhe nuk mund të përballohet as me kujdesin e duhur.

8.3. Pala e ndikuar nga një ngjarje e forcës madhore do të marr të gjitha masat e arsyeshme për të mënjanuar paaftësinë e një pale të tillë që të përbush detyrimet e saj tani e tutje me një vonesë minimale.

8.4. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të jetë përgjegjës për dëmet e likuiduara ose ndërprerje nëse vonesa e tij në realizimin ose dështimi për të realizuar obligimet e tij me kontratë është rezultat i një ngjarjeje të forcës madhore. Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i detyruar të paguajë interes për pagesat e vonuara, për mosrealizim ose për ndërprerje nëse vonesa e Autoritetit kontraktues ose lloj tjetër i dëshimit për të kryer obligimet e tij është rezultat i forcës madhore.

8.5. Nëse ndonjëra palë konsideron se ndonjë rrethanë e forcës madhore ka ndodhur e cila mund të ndikojë në realizimin e obligimeve të saj, rrerjelerë do ta larmërojë palen jetër, duke dhënë të dhëna detaje mbi natyren, kohëzgjatjen e mundshme dhe efektin që kanë gjasa ta kenë rrethanat. Përveç nëse udhëzohet ndryshe nga Menaxheri i Projektit me shkrim, Ofruesi i Shërbimeve do të vazhdojë t'i realizojë obligimet e tij sipas kontratës përderisa është mjart praktike, dhe të angazhojë të gjitha mjetet e arsyeshme alternative për të plotësuar ndonjë obligim që ngjarja e forcës madhore të mos e pengojë atë gjatë punës. Ofruesi i Shërbimeve nuk do të zbatojë mjetet e tilla alternative përveç nëse udhëzohet ta bëjë këtë nga Menaxheri i Projektit.

Neni 9 Ndërprerja e Kontratës nga Autoriteti Kontraktues

9.1 Autoriteti kontraktues mundet që, pasi t'i japë Ofruesit të Shërbimeve 14 ditë paralajmërim, ta ndërpresë kontratën në ndonjërin nga rastet e mëposhtme:

- (a) Ofruesi i Shërbimeve dështon në përbushjen brenda një afati të arsyeshëm të paralajmërimit të dhënë nga autoriteti kontraktues që kërkon nga ai të evitojë ndonjë neglizhencë apo dështim për të realizuar obligimet e veta sipas kontratës, dhe të cilat ndikojnë në mënyrë serioze në realizimin e duhur dhe më kohë të shërbimeve;
- (b) Ofruesi i Shërbimeve refuzon ose është neglizhent në realizimin e urdhreve administrative të dhëna nga autoriteti kontraktues;
- (c) Ofruesi i Shërbimeve ia jep dikujt kontratën apo nënkontratën pa autorizim nga Autoriteti kontraktues;
- (d) Ofruesi i Shërbimeve falimenton ose është duke u myllur; punët e tij janë duke u administruar nga gjykatat, ka hyrë në marrëveshje me kredituesit, ka pezulluar aktivitetet biznesore, i nënshtronhet procedurave ligjore lidhur me ato çështje, ose është në ndonjë situatë analoge që shkaktohet nga ndonjë procedurë e ngjashme e paraparë në legjislacionin apo në rregulloret nacionale;
- (e) Ofruesi i Shërbimeve është dënuar për një shkelje që ka të bëjë me sjelljen profesionale, përmes një gjykimi që ka fuqinë e *res judicata*;
- (f) Ofruesi i Shërbimeve është shpallur fajtor për sjellje të rëndë të keqe jo profesionale të dëshmuar me çfarëdo mjeti të cilin mund ta vërtetoj Autoriteti kontraktues;
- (g) Ofruesi i Shërbimeve i është nënshtruar një gjykimi që ka forcën e *res judicata* për mashtrim, korruption, përfshirje në ndonjë organizatë kriminale;
- (h) të gjitha modifikimet organizative që përfshijnë ndryshime në personalitetin ligjor, natyrën ose kontrollin e Ofruesit të Shërbimeve, përveç nëse këto modifikime regjistrohen në suplementin e kontratës;
- (i) shfaqet ndonjë paaftësi tjetër ligjore që i pengon realizimit të kontratës;
- (j) Ofruesi i Shërbimeve nuk arrin të japë garancinë ose sigurimin e kërkuar, ose nëse personi që e jep garancinë apo sigurimin më të hershmë të kërkuar në kontratën e tanishme nuk është në gjendje t'i plotësojë zotimet e tij.

9.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim ndaj të drejtave apo mundësive tjera të Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve sipas kontratës. Autoriteti kontraktues, pas kësaj mund të nënshkruejë ndonjë kontratë tjetër me një palë të tretë në emër të Ofruesit të Shërbimeve.

9.3 Autoriteti Kontraktues, pas lëshimit të njoftimit të ndërprerjes së kontratës, do ta udhëzojë Ofruesin e Shërbimeve që të ndërmarrë hapa të menjëherëshëm për ta përmbyllur ekzekutimin e shërbimeve në mënyrë të shpejtë dhe të rregullt dhe për t'i zvogëluar në minimum shpenzimet.

9.4 Në rast të ndërprerjes, autoriteti kontraktues, sa më shpejt që të jetë e mundur dhe në prani të Ofruesit të Shërbimeve ose të përfaqësuesve të tij ose duke u bërë atyre thirrjen e duhur, do ta përgatisë një raport mbi shërbimet e kryera. Do të përgatitet edhe një deklaratë e parave që duhet t'i paguhen Ofruesit të Shërbimeve dhe parave që i ka borxh Ofruesi i Shërbimeve Autoritetit kontraktues në datën e ndërprerjes së kontratës.

9.5 Autoriteti kontraktues nuk do të jetë i obliguar të bëjë pagesa tjera për Ofruesin e Shërbimeve derisa të jenë përfunduar shërbimet, ndërsa Autoriteti kontraktues do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve koston ekstra, nëse ka, për të siguruar ofruesin e shërbimeve ose do të paguajë shumën që duhet t'i paguhet Ofruesit të Shërbimeve para ndërprerjes së kontratës.

9.6 Nëse Autoriteti kontraktues e ndërpret kontratën, ai do të ketë të drejtë të marrë nga Ofruesi i Shërbimeve humbjet që i janë shkaktuar nën kushtet e kontratës.

Neni 10 Ndërprerja e Kontratës nga Ofruesi i Shërbimeve

10.1 Ofruesi i Shërbimeve, pasi e ka paralajmëruar Autoritetin kontraktues 14 ditë paraprakisht, mund ta ndërpresë kontratën nëse Autoriteti kontraktues;

- a. nuk arrin t'i paguajë Ofruesit të Shërbimeve shumat që duhet të paguhen në ndonjë certifikatë të lëshuar nga personi i autorizuar pas skadimit të afatit të fundit;
- b. vazhdimisht nuk arrin t'i plotësojë obligimet e veta edhe pas rikujtimeve të përsëritura; ose
- c. ose, si rezultat i Forcës Madhore, Ofruesi i Shërbimeve është i paaftë të kryej një pjesë materiale të Shërbimeve për një perludhë prej jo më pak se gjashtëdhjetë (60) ditë.

10.2 Ndërprerja do të bëhet pa paragjykim për ndonjë të drejtë apo autoritet tjetër sipas kontratës së Autoritetit kontraktues dhe Ofruesit të Shërbimeve.

10.3 Në rast të ndërprerjes sipas paragrafit (a) dhe (b) te Seksionit 10.1, Autoriteti kontraktues do ta paguajë Ofruesin e Shërbimeve për humbje ose dëm që mund t'i jetë shkaktuar Ofruesit të Shërbimeve.

Neni 11 Obligimet e Ofruesit të Shërbimeve

11.1 Ofertuesi do të kryejë Shërbimet sipas kontralës me kujdes, efikasitet dhe zell, në përputhje me praktikat më të mira profesionale.

11.2 Ofruesi i Shërbimeve duhet të pajtohet me urdhërat administrative të dhëna nga Autoriteti Kontraktues. Kur Ofrues i shërbimeve konsideron se kërkesa e një urdhri administrativ shkon përtëj fushëveprimit të kontratës, ai, duke iu ekspozuar dënimit për shkelje të kontratës, do ta njoftojë autoritetin kontraktues për këtë duke i paraqitur arsyet e tij brenda 30 ditësh pas pranimit të urdhrit. Ekzekutimi i urdhrit administrativ nuk do të pezullohet për shkak të këtij njoftimi.

11.3 Ofruesi i Shërbimeve duhet t'i respektojë dhe të veprojë sipas të gjitha ligjeve dhe rregulloreve në fuqi në Republikën e Kosovës dhe do të sigurojë që personeli i tij, të afërmit e tyre, dhe punëtorët vendorë të tij gjithashtu t'i respektojnë dhe të veprojnë sipas këtyre ligjeve dhe rregulloreve.

11.4 Ofruesi i Shërbimeve do të trajtojë të gjitha dokumentet dhe informacionet e marra në lidhje me kontratën si private dhe konfidenciale. Ai nuk do të shpëtojë për aq kohë sa të jetë e nevojshme për qëllimet e ekzekutimit të kontratës, të botojë ose të zbulojë ndonjë lë dhënë të kontratës, pa pëlqim paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.5 Nëse ofruesi i shërbimit është një konsorcium i dy ose më shumë personave ose korporatave, të gjithë personat ose korporatat e tillë do të janë së bashku dhe veçmas të detyruar për të përmbushur kushtet e kontratës. Personi i caktuar nga konsorciumi për të vepruar në emër të tij për qëllimet e kësaj kontrate do të ketë autoritetin për të lidhur konsorciumin. Përbërja e grupit nuk do të ndryshohet pa pëlqimin paraprak me shkrim të Autoritetit Kontraktues.

11.6 Ofruesi i Shërbimeve do të punësojnë personelin kyç të identikuara në tenderin e tij për të kryer funksionet e përcaktuara në tenderin e tij. Për më tepër, gjatë performancës, dhe në bazë të një kërkese me shkrim dhe të arsyetur, autoriteti kontraktues mund të kërkojë një zëvendësim nëse vlerëson se një anëtar i stafit është i paefektshëm ose nuk kryejnë detyrat e tij sipas kontratës. Autoriteti Kontraktues do të miratojë çdo zëvendësim të

personelit kryesor të propozuar vetëm nëse kualifikimet e tyre përkatëse dhe aftësitë në thelb janë të barabarta ose më të mirë se ato të identifikuara.

Neni 12 **Obigimet e Autoritetit Kontraktues**

12.1 Autoriteti Kontraktues do të ofrojë ofruesit të shërbimit menjëherë me ndonjë informacion dhe / ose dokumente në dispozicion të saj, të cilat mund të janë relevante për zbatimin e kontratës. Dokumente të tilla duhet ti kthehen Autoritetit Kontraktues në fund të periudhës së zbatimit të detyrave.

12.2 Autoriteti Kontraktues do të bashkëpunojë sa më shumë të jetë e mundur me ofruesin e shërbimit për të siguruar informacion që ky i fundit mund të kërkojë në mënyrë të arsyeshme për të kryer kontratën.

12.3 Autoriteti Kontraktues do të caktoj "Menaxherin e Projektit", i cekur në KVK, i cili do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen e kryerjes së shërbimeve gjatë gjithë kohës dhe për raportimin e çdo hollësie Autoritetit Kontraktues.

Neni 13 **Dëmet e Likuiduara**

13.1 Nëse Ofruesi i sherbimeve me përgjegjësinë e tij nuk arrin t'i realizoje ndonjë ose të gjitha sherbimet brenda limiteve kohore të specifikuara në kontratë, Autoriteti Kontraktues, pa njoftim zyrtar dhe pa paragjykim ndaj kompensimeve tjera të tij sipas kontratës, do të ketë të drejtë, për secilën ditë që kalon ndërmjet skadimit të periudhës së kontratës dhe datës aktuale të përfundimit, t'i marrë dëmet e likuiduara të barabarta me **0,25%** në ditë të vlerës se sherbimeve të pa kryera deri në një maksimum prej 10 % të vlerës totale të porosise. Autoriteti Kontraktues mund të zbrësë dëmet e likuiduara nga pagesat te cilat duhet ti behen Ofruesit te Sherbimeve. Pagesat e dëmeve të likuiduara nuk do të prekin delyrimet e Ofruesit te Sherbimeve.

13.2 Nëse mos-ekzekutimi i ndonjërit sherbime parandalon përdorimin e zakonshëm të sherbimeve në tërësi, dëmet e likuiduara të parapara në paragrafin 13.1 do të llogariten në bazë të vlerës totale të porosise.

13.3 Nëse Autoriteti kontraktues ka fituar të drejtën të kërkojë së paku 10 % të vlerës së porosise ai mundet, pasi ta rijoftojë më së shkrirë Ofruesin e Sherbimeve të:

a. *Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem ne emer te vete Autoritetit, me nje operatore ekonomik:*

- konfiskojë garancinë e performancës;
- te ndërpresë kontratën, dhe në këtë rast Ofruesi i Sherbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim; dhe
- të hyjë në një kontratë me një palë të tretë për dhënien e pjesës së mbetur të sherbimeve. Ofruesi i sherbimeve nuk do të paguhet për këtë pjesë të kontratës. Ofruesi i Sherbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij.

b. *Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar vetem ne emer te vete Autoritetit, me disa operatore ekonomik:*

- te konfiskojë garancinë e realizimit;
- te ndërpresë porosine, dhe në këtë rast Ofruesi i Sherbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Sherbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

c. *Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoritetetëve tjera Kontraktuese, me nje operatore ekonomik:*

- Autoriteti Kontraktues i cili ka bere porosine anulon porosine dhe ritenderon, dhe në këtë rast Ofruesi i Shorbimove nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Sherbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo pamundësi e tij; dhe
- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kérkon nga Autoriteti Kontraktues i përmendur qe të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues.

a. *Ne rast se Autoriteti Kontraktues ka prokuruar ne emer te disa Autoritetetëve tjera Kontraktuese, me disa operatore ekonomik:*

- te njoftoj Autoritetin Kontraktues i cili ka udhëhequr prokurimin për sjellje të keqe të Operatorit Ekonomik dhe kérkon nga Autoriteti Kontraktues i përmendur qe të konfiskoj një pjesë proporcionale, ekuivalente me 10% te porosise se leshuar, të garancisë së performancës dhe dërgon shumën tek Autoriteti Kontraktues;
- te ndërpresë porosine, dhe në këtë rast Ofruesi i sherbimeve nuk do të ketë të drejtë për kompensim. Ofruesi i Sherbimeve gjithashtu do të jetë i detyruar të paguajë koston plotësuese dhe dëmet e shkaktuara nga kjo

pamundësi e tij; dhe
- te ri-hap konkurrencën me pjesën e mbetur të Operatorëve Ekonomik të kontratës publike kornizë.

Neni 14 Siguria e Ekzekutimit

14.1 Ofruesi i shërbimeve do të, jo më vonë se dita e nënshkrimit të kontratës, furnizoj Autoritetin Kontraktues me siguri për ekzekutim të plotë dhe të mire të kontratës. Shuma e sigurisë do të saktësohet në KVK. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit Kontraktues për çfarëdo humbeje që është pasojë e mosekzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Ofruesit të Shërbimeve.

14.2 Garancioni do të vazhdojë të mbetet i vlefshëm 30 ditë pas lëshimit të Çertifikatës së Përfundimit.

14.3 Garanconi i ekzekutimit të kontratës do të jetë në formatin e dhënë në Pjesën IV të kësaj kontrate.

Neni 15 Sigurimi që do të merret nga Ofruesi i Shërbimit

15.1 Ofruesi i Shërbimeve do të marr dhe do të ruaj, dhe do të shkaktoj Nënkontraktorët të marrin dhe ruajnë, me shpenzimet e tyre, por në bazë të kushteve të miratuara nga Autoriteti Kontraktues, sigurimin nga rreziqet, dhe përmbulim, siç do të specifikohet në KVK.

15.2 Ofruesi i Shërbimeve, me kërkesë të Autoritetit Kontraktues, do të ofroj dëshmi për Autoritetin Kontraktues që sigurimi i tillë është marrë dhe ruajtur dhe se primet e tanishme janë paguar.

Neni 16 Parimet të përgjithshme të pagesave

16.1 Pagesat do të bëhen në Euro. Pagesat që duhet te bëhen sipas faturës se lëshuar nga Ofruesi i Shërbimeve do të bëhen në llogarinë bankare të dhënë në Pjosën V, **Identifikimi Financiar**, i kësaj kontrate që e plotëson Ofruesi i Shërbimeve. I njëjlli formular, që i bashkëngjitet kërkesës për pagesë, duhet të përdoret për t'i raportuar ndryshimet në llogarinë bankare.

16.2 Shumat duhet të paguhen brenda jo më shumë se 30 ditësh kalendarike nga data në të cilën kërkesa e pranueshme për pagesë është regjistruar nga departamenti përkatës. Data e pagesës do të jetë data në të cilën debitohet llogaria e institucionit. Kërkesa për pagesë nuk do të jetë e pranueshme nëse nuk plotësohen një ose më shumë nga kërkesat thelbësore.

16.3 Periudha prej 30-ditësh mund të pezullohet duke e lajmëruar ofruesin e Shërbimeve që kërkesa për pagesë nuk mund të plotësohet sepse shuma nuk do të paguhet për shkak se nuk janë dorëzuar dokumentet e duhura përmirësuese ose sepse ka dëshmi që shpenzimet mund të mos jetë legjitime. Në rastin e fundit mund të bëhet një inspektim i menjëhershëm për qëllim të kontrollimeve tjera. Ofruesi i Shërbimeve do të japë sqarime, modifikime apo informata të tjera brenda 15 ditësh pas kërkesës. Periudha e pagesës do të llogaritet nga data në të cilën është regjistruar kërkesa për pagesë e përgatitur në mënyrën e duhur.

16.4 Pasi që të ketë kaluar afati i fundit i dhënë në Nenin 16.2, Ofruesi i Shërbimeve mundet që, brenda dy muajsh pas pagesës së vonuar, të kërkojë interesin për pagesë të vonuar me normë të re-zbritje që zbatohet nga Banka Qendrore e Kosovës në ditën e parë të muajit në të cilin ka skaduar afati i fundit, plus shtatë pikë të përqindjes. Interesi për pagesë të vonuar do të zbatohet për kohën që kalon ndërmjet datës së afatit të fundit të pagesës (nuk përfshihet) dhe datës në të cilën debitohet llogaria e Autoritetit Kontraktues (përfshihet).

16.5 Të gjitha mos pagesat pas 90 ditësh nga skadimi i periudhës së dhënë në Nenin 16.2 do t'i jasin të drejtë Ofruesit të Shërbimeve që, ose të mos e realizojë kontratën, ose ta ndërpresë atë, me paralajmërim prej 30 ditësh për Autoritetin Kontraktues.

16.6 Në rast se Autoriteti Kontraktues kryen blerje në emër të autoriteteve të tjera kontraktuese, dhe një autoriteti Kontraktues nuk i përbush detyrimet e tij sipas kësaj kontrate, veçanërisht obligimet e Nenit 16.2 ofruesi i shërbimeve mund të informojë AQP-ne për shkelje të tillë. AQP-ja mund të ndalojë autoritetin Kontraktues nga përdorimi i çdo dhe të gjitha kontratat qendrore publike kornizë të nxjerra nga AQP.

Neni 17 Kualiteti i Kontrollit

17.1 Parimi dhe modalitetet e Inspektimit të Shërbimeve nga Autoriteti Kontraktues do të jenë si në KVK. Autoriteti Kontraktues do të kontrollojë punën e ofruesit të shërbimeve dhe të njoftojë atë për çdo defekt që është gjetur. Kontrolli

i tillë nuk do tē ndikojë nē përgjegjësitë e ofruesit tē shërbimeve. Autoriteti Kontraktues mund tē udhëzojë ofruesit e shërbimeve tē kërkojnë një defekt dhe tē zbulojnë dhe provojnë çdo shërbim që Autoriteti Kontraktues konsideron se mund tē ketë një defekt. Periudha garantuese e defekteve është siç eshte definuar nē KVK.

Neni 18 Përmirësimi i Defekteve

18.1 Autoriteti kontraktues do tē njoftojë ofruesit e shërbimeve për çdo Defekt para përfundimit tē kontratës. Periudha garantuese e defekteve do tē zgjatet për aq kohë sa Defektet tē korrigohen.

18.2 Sa herë njoftimi për një defekt është dhënë, ofruesi i shërbimeve duhet tē përmirësoj defektin e njoftuar brenda kohës së specifikuar nē njoftimin e Autoritetit Kontraktues

18.3 Nëse ofruesi i shërbimeve nuk e ka korrijuar defektin brenda kohës së specifikuar nē njoftimin e Autoritetit Kontraktues, Autoriteti Kontraktues do tē vlerësoj koston e korrigimit tē defektit, ofruesi i shërbimeve do tē paguaj këtë shumë, dhe do pasoj një dënim për mungesë Ekzekutimi që llogaritet siç përshkruhet nē nenin 13.1.

Neni 19 Konsekuençat e Shkeljes se kontratës

19.1 Pala ka shkelë kontratën nëse nuk arrin tē shlyejë ndonjë nga obligimet e veta mo kontratë siç është cekur ne Nenin 9 dhe 10.

19.2 Në rastet kur ndodh një shkelje e kontratës, pala e dëmtuar do tē ketë tē drejtë për këto kompensime:

- a) dëmet; dhe/apo
- b) ndërprerje tē kontratës.

19.3 Përveç masave tē sipërpëmendura, mund tē jepen dëmshpërblime. Ato mund tē jenë:

- a) dëme tē përgjithshme; ose
- b) dëme tē likuidueshme.

19.4 Mbulimi i dëmeve, pagesat apo shpenzimet që rezultojnë nga zbatimi i masave tē parapara nē këtë nen do tē zbatohen duke u zbritur nga shumat që duhet t'i paguhen Ofruesit tē Shërbimeve, nga depozita, ose me pagesë nga siguria.

Neni 20 Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve

20.1 Palët duhet t'i bëjnë tē gjitha përpjekte për tē zgjidhur nē mënyrë miqësore tē gjitha mosmarrëveshjet që mund tē ndodhin ndërmjet tyre. Sapo tē shfaqet ndonjë mosmarrëveshje, palët do ta lajmërojnë njëra tjetrën me shkrim për qëndrimet e tyre nē mosmarrëveshje dhe për ndonjë zgjidhje që ata konsiderojnë se është e mundshme. Nëse cilado palë e sheh tē dobishme, palët do tē takohen dhe tē mundohen ta zgjidhin mosmarrëveshjen. Pala do tē i përgjigjet kërkësës për zgjidhje miqësore brenda 15 ditësh pas kërkësës. Periudha maksimale që jepet për arritjen e kësaj zgjidhjeje do tē jetë 30 ditë nga fillimi i procedurës. Nëse përpjekja për tē arrihit zgjidhje miqësore dështon ose nëse pala dështon tē përgjigjet me kohë ndaj kërkësave për zgjidhje, tē dyja palët do tē jenë tē lira tē vazhdojnë nē fazën e ardhshme tē procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes duke e lajmëruar tjetrën.

20.2 Nëse procedura e zgjidhjes miqësore tō moemarrëveshjes dështon, palët mund tē merrin veshi tē përpjekën tē pajtohen përmes institucionit tē specifikuar nē KVK. Nëse nuk mund tē arrihet zgjidhja brenda 30 ditësh pas fillimit të procedurës së pajtimit, secila palë do tē ketë tē drejtë tē vazhdojë nē fazën e ardhshme tē procedurës së zgjidhjes së mosmarrëveshjes.

Neni 21 Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore

21.1 Nëse nuk mund tē arrihet zgjidhje brenda 30 ditësh nga fillimi i procedurës miqësore për zgjidhje tē mosmarrëveshjes, secila palë mund tē kërkojë:

- a) vendim nga gjyqi; ose
- b) kurdo qe palët pajtohen, vendim arbitrimi nē pajtim me KVK.

21.2 Para nënshkrimit te kontratës palët duhet te vendosin për mënyrën e zgjidhjes se mosmarrëveshjes, gjykata apo arbitrimi.

Neni 22 Dëmshpërblimi

22.1 Ofruesi i shërbimeve do te mbroje dhe do te dëmshpërblej Autoritetin Kontraktues, zyrtaret e tij dhe ish zyrtaret, drejtoret, punonjësit dhe agjentet e tij dhe do te jetë përgjegjës për te gjitha shpenzimet, humbjet, demet, dhe pagesat e shkaktuara nga Autoriteti Kontraktues, duke përfshire por jo kufizuar shpenzimet e tarifës se avokateve dhe shpenzimet ne lidhje me: neglizhencën ose keqpërdorimet e qëllimshme nga ana e ofruesit të shërbimeve, shkeljet apo shkeljet e pretenduar nga prezantimet e Ofruesit te Shërbimeve, pretendimet nga një palë e tretë se sigurimi i atyre shërbimeve nga ofruesi i shërbimit apo shfrytëzimi i tyre nga apo në emër të Autoritetit Kontraktues apo përdorimi ose sigurimi i ndonjë aseti te siguruar nga ofruesi i shërbimeve në lidhje me kryerjen e shërbimeve shkel të drejtat e pronësisë intelektuale të asaj pale të tretë.

PJESA III E KONTRATËS

KUSHTET E VEÇANTA

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet / Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Nr. Nenit	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksiioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
Obligimet e Autoritetit Kontraktues	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë gjuha shqipe
Siguria e ekzekutimit	12.3	Menaxher i Projektit është: Ejup Qyqalla i caktuar nga Autoriteti Kontraktues për menaxhim të kontratës.
Sigurimi që do të merret nga ofruesi i shërbimit	14.1	Shuma e Sigurisë së ekzekutimit është 10% e vlerës së kontratës në kohëzgjatje prej 30 ditësh pas implementimit te kontratës dhe do të dorëzohet në ditën e nënshkrimit të kontratës. Siguria e ekzekutimit do të ndalet nga pagesa e Autoritetit Kontraktues për çfarëdo humbje që është pasojë e mosëkzekutimit të plotë dhe të duhur të obligimeve kontraktore nga ana e Kontraktuesit.
Kualiteti i Kontrollit	15.1	Ofertuesi do të siguroj se të gjitha shërbimet do të realizohen brenda afatit të përcaktuar nga Autoriteti Kontraktues dhe sipas kërkesave të paraqitura.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes	17.1	Parimi dhe modalitetet e inspektimit të shërbimeve nga Autoriteti Kontraktues janë si më poshtë: Periudha e përgjegjësisë së Defekteve është sa kohëzgjatja e kontratës kornizë.
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjes me procedure gjyqësore	20.2	<i>Palët do të përpiken që çdo mosmarrëveshje në mes tyre ta zgjidhin përmes Komisionit për Ankesa dhe Parashtresa pran Autoritetit Kontraktues</i>
	21.1	a) Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet në Gjykatën Themelore në pajtim me ligjin në Kosovë.

Shërbimet e zhvendosjes (me merimangë) dhe blokimit të automjeteve në territorin e Komunës së Fushe Kosove.

Nr. rendor	Përshtkimi	Njësia	Sasia	Çmimi €	Shuma €	Pikët
1	Zhvendosja/Tërheqja e Motoçikletës, traktorit dhe veturës pa romorkio, brenda qytetit, deri në vendin për vendosje dhe ruajtjen e tyre deri në 24 orë	automjet	1.00	25.00	25.00	50
2	Zhvendosja/Tërheqja e autonjitet transportues, rimorkio, gysën rimorkio prej 3,5 ton e tutje si dhe autobusëve deri në vendosjen dhe ruajtjen e tyre deri në 24 orë	automjet	1.00	1.00	1.00	10
3	Deponimi/nëse automjeti mbetet I deponuar në parkirg pas 24 orëve nga koha e marrjes, atëherë për të njëjtin pronarë (drexuesi) apo personi I autorizuar paguan për cdo 24 ore të deponimit. Llogaria e 24 orësh të radhës fillon menjëherë pas kanë kaluar 24 orë që nga ora e tërheqjes së autonjitetit	automjet	1.00	3.00	3.00	20
4	Zhvendosja/Tërheqja e mijetit (veturë, traktor, autobus kamion motocikletë etj) vjetëm kur fillon por nuk bëhet zhvendosja deri në vendin e rrujties/Deponimit	automjet	1.00	10.00	10.00	10
5	Zbllokimi I mijeteve, autobusëve, mijeteve transportuese, mijetet e punës dhe rimorkio	automjet	1.00	1.00	1.00	10
		totali		40.00	40.00	100
	çmimi total			12.50	12.50	
1		25.00				
2		1.00		0.10	0.10	
3		3.00		0.60	0.60	
4		10.00		1.00	1.00	
5		1.00		0.10	0.10	
		40.00		14.30	14.30	
	Çmimi i Total i peshuar (ofertat do të vlerosen në bazë te kesaj vlerë). Kjo është vlera e cila do të duhet te shenohet ne Formularin e ofertes					
	Kjo përgatitje është bërë, Në mbështetje të ligjit 02/L-70 dhe udhëzimit administrativ 02/2009.					
	VËREJTJE : Të hyrat komunale duhet te jene 25 % per te gjitha pozicionet ne pershkrimin e çmimeve.					